



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca Plenare**

Seanca nr.2004/02

Prishtinë, më 29 janar 2004, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi Nexhat DACI, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Xhavit HALITI, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 102 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance, si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës;
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për barazi gjinore;
4. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit kundër diskriminimit dhe
5. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për materialin fidanor.

Kryetari kërkoi të procedohet sipas rendit të ditës, të miratuar në seancën e mëparshme.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

## 2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës.

**Kryetari** i informoi deputetët për raportet dhe për rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit FunkSIONAL për këtë P/ligj dhe e hapi diskutimin lidhur me to.

**Bedri Selmani** i bëri vërejtje raportit dhe rekomandimeve të Komisionit FunkSIONAL dhe kërkoi që Kuvendi t'i merrë në shqyrtim amendamentet që i kishte paraqitur ai në këtë p/ligj.

**Fatmir Rexhepi** i arsyetoi raportin dhe rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL. Ai theksoi se nuk kanë mbështetje vërejtjet e parafolësit lidhur me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL.

**Arsim Bajrami** theksoi se Kuvendi e ka miratuar në parim këtë p/ligj, kurse amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL e ndryshojnë emërtimin, konceptin dhe strukturën e këtij p/ligji. Ai kërkoi nga propozuesi i P/ligjit të deklarohet për këto amendamente.

**Ministri Ali Sadriu** theksoi se gjatë arsyetimit të p/ligjit, në shqyrtimin e parë, i ka paraqitur dy variante të tij: a) anëtarimin e detyrshëm dhe b) anëtarimin vullnetar në Odën Ekonomike. Ai i përkrahu amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

**Bujar Dugolli** i bëri vërejtje mënyrës së radhitjes së amendamenteve dhe kërkoi që të bëhet radhitja sipas mënyrës së mëparshme, në të cilën duhet të përfshihen amendamente e çdo deputeti, komisioni dhe grupi parlamentar.

**Sabri Hamiti** theksoi se Kuvendi duhet të procedojë sipas procedurës legislative dhe kërkoi të votohet sipas radhitjes të amendamenteve.

**Kryetari** theksoi se amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nuk janë në përputhje me standardet juridike të Bashkimit Evropian dhe me përvojat e vendeve të rajonit dhe të Evropës Perendimore.

**Hydajet Hyseni** kërkoi të respektohet praktika e mëparshme e radhitjes së amendamenteve dhe të shqyrtohen të gjitha amendamentet e propozuara për këtë p/ligj.

**Dragisha Krstović** kërkoi të bëhet radhitja e të gjitha amendamenteve të propozuara për këtë p/ligj dhe shqyrtimi i dytë i tij të shtyhet për seancën e ardhshme.

**Hasan Meta** i përkrahu vërejtjet e Bedri Selmanit dhe të Bujar Dugollit dhe kërkoi që shqyrtimi i dytë i këtij p/ligji të shtyhet për seancën e ardhshme.

**Kryetari** dha një pauzë prej 15 minutash dhe kërkoi që të takohen kryetarët e grupeve parlamentare për t'i harmonizuar qëndrimet rreth procedimit të këtij p/ligji.

Pas pauzës, **kryetari** theksoi se gjatë takimit, kryetarët e grupeve parlamentare nuk kanë arritur konsensus për procedimin e këtij p/ligji. Janë dy propozime: a) Të vazhdohet me procedimin e këtij p/ligji dhe b) Shqyrtimi i tij të shtyhet për seancën e ardhshme.

**Kryetari** konstatoi se në senacë ishin të pranishëm 99 deputetë dhe e hodhi në votë propozimin e parë dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----48.

**Kryetari** konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin për procedimin e P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës.

**Kryetari** e deklaroi të mbylur seancën plenare në orën 12:15 minuta.

**Sekretaria e Kuvendit**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës**

\_\_\_\_\_  
**Akademik Nexhat DACI**